

V E N D I M

Nr. 807, datë 24.12.1998

PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË DEKLARIMIT TË PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr. 7903, datë 8.3.1995 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, me propozimin e

Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Anëtarët e komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik, të shpërblehen për punën e kryer në masën 10 000 lekë në muaj.
2. Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në buxhetin e miratuar për vitin 1998 i shtohet një fond prej 108 mijë lekësh, për shpërblimin e anëtarëve të komisionit.
3. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.3.1998

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko